



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 184 / Prot.
01

Datë 15.02.2017

Lënda: Mbi kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kavajë

Drejtuar: Z. Elvis RROSHI
Kryetar
Bashkia Kavajë

Për dijjeni: **Bashkimi i Operatorëve ekonomik Atelier 4 shpk & Instituti i Politikave Publike dhe Private**
Adresa: Rr. Sami Frashëri, Pallati TID Ballkan, Shk. 1/2

I nderuar Z. Rroshi,

Në vijim të shkresës Tuaj, Nr. 365 Prot., datë 01.02.2017, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Territorit me Nr. 184 Prot., datë 03.02.2017, me lëndë: “Kërkesë për pajisje me Aktin e Përputhshmërisë të PPV-së”, dhe botimit të dokumenteve të PPV-së së Bashkisë Kavajë në Regjistrin e Integruar të Territorit, më 02.02.2017, AKPT ka kryer kontrollin e përputhshmërisë sipas legjislacionit të planifikimit dhe atij sektorial.

Për të qënë në përputhje me legjislacionin e planifikimit, në PPV-në e Bashkisë Kavajë, duhet të reflektohen ndryshimet e mëposhtme në Rregulloren e PPV-së:

- **Njësitë G2-A22-01, G2-A22-02, G2-A22-03, G2-A22-04, G2-A22-05, G2-A22-06 dhe G2-A22-09** (Qerret), bëjnë pjesë në Zonën e Rëndësisë Kombëtare të Brezit Bregdetar, për të cilën jep indikacione Plani i Përgjithshëm Kombëtar dhe Plani i Integruar Ndër-Sektorial për Bregdetin.

Sipas PINS Bregdetit, zona duhet të orientohet drejt turizmit elitë, zhvillimeve në formën e viletave (2-3 kate), duke siguruar infrastrukturën, shërbimet publike dhe hapësirat e gjelbra në masën e duhur. Zhvillimet në bregdet duhet të orientohen drejt një forme tjetër të aktivitetit ekonomik turistik, jo më duke mbështetur banesa / njësi pushimi private, por facilitete për përdorim publik të menaxhuara nga sektori privat.

Për të drejtuar zhvillimin e këtyre njësisve, nevojitet hartimi i një **Plani të Detajuar të Zonës së Rëndësisë Kombëtare (PDZRK)**, i cili do të detajojë treguesit e zhvillimit dhe

mënyrën e ndërhyrjes. Pra, PPV për këto njësi duhet të japë orientime të përgjithshme, duke respektuar indikacionet e PINS Bregdetit, të cilat do të jenë subjekt i mëtejshëm i PDZRK-së për zonën.

Me reflektimin e këtyre çështjeve, AKPT do të angazhohet për lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë, në mënyrë që të vijohet me miratimin e PPV-së në Këshillin Bashkiak, dhe Këshillin Kombëtar të Territorit.

Me respekt,

Adelina GRECA



DREJTORE E PËRGJITHSHME

